

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**“\_\_\_\_\_” SH.P.K**  
**ME SELI NË TIRANË**

Sot, më datë 02/03/2020 (dymijë e njëzete), ortakët themelues:

**THEMELUES/IT:**

Klajdo Pilua, atësia Foni, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në TIRANE, me adresë 1052 Yzberish Rr.'Migjeni' Nd.7 hyrja22 ap.6, lindur më 25/09/1992, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identitetifikuar me ID nr. 031955115 dhe nr. personal J20925073G ,

**THEMELUES/IT:**

Blerina Shkurta, atësia Abedin, amësia Klementina, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banuese në TIRANE, me adresë Tiranë 11 Pandi Dardha 013 1, lindur më 29/09/1983, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me ID nr. 029852818 dhe nr. personal I35929073F ,

të cilët përpiluan e këtë kontrate themelimi të shoqërisë tregtare “UTILITY SHOP” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Themelimi i Shoqërisë Tregtare “UTILITY SHOP” SH.P.K, e formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vazhdim Shoqëria). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “UTILITY SHOP” SH.P.K

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

*Objekti i veprimtarisë së shoqërisë shtrihet në fushat e mëposhtme:*

Ngritja, hapja edhe administrimi i një pike shitje tip marketi, blerja dhe shitja e artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor dhe jo ushqimor, të përpunuar dhe jo të përpunuar. Kryerja e shërbimeve të ndryshme utilitare si edhe shërbimeve të tjera në dobi të aktivitetit kryesor të cilat nuk e tjetërsojnë këtë aktivitet edhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin shqipëtar në fuqi.

Të gjitha veprimtaritë do të zhvillohen në përputhje me ligjin që rregullon ushtrimin e asaj veprimtarie. Shoqëria do të marrë të gjitha licencat dhe miratimet që mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të sipërpërmendura sipas kërkesave të ligjit të fushës.

Klajdo Pilua  


Blerina Shkurta  


**NENI 4**  
**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Rinasit, Tirana Business Park, Ndërtesa 07, Kati 0, Tiranë, Vorë.

**NENI 5**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën **10.000 (dhjete mijë) Lek**, e ndarë në 2 kuota. Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

1. **Znj. Blerina Shkurta**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **50%** të vlerës së kuotave në kapitalin themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 5000 lekë në kapitalin themeltar.
2. **Z. Klajdo Pilua**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **50 %** të vlerës së kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 5000 lekë në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar është investuar nga partnerët themelues në total. Kapitali fillestar është nënshkruar por do të paguhet menjëherë pas regjistrimit të Aktit dhe Statuti pranë QKB.

**NENI 6**  
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.


**NENI 7**  
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë do të jetë **Znj. Arjola PILUA**, e bija e Fonit, e datëlindjes 25.01.1997 lindur në Berat dhe banuese 1052 Yzberish Rr.Migjeni Nd.7 Hyrja22 Ap.6, Kashar, Tiranë madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimi me nr. personal J75125058A.

*Klajdo Pilua*  


*Blerina Shkurta*  


Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

**NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 9**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 10**

**Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 11**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 12**

**Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua dhe firmos me vullnet të lirë nga Ortakët Themelues.

**ORTAKËT THEMELUES**

**Klajdo Pilua**

**Blerina Shkurta**